



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 51
Prishtinë, më 07.07.2010 në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. C- 203

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Arsim Rexhepi, kryetar, Drita Kadriu, Enis Kervan, Adem Hajdaraj, Donika Kadaj –Bujupi, Haset Cakolli, Ismajl Kurteshi dhe Dragan Dimiq.

Mungoi Mark Krasniqi.

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli

Mbledhjen e udhëhoqi: Arsim Rexhepi kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 24.06.2010,
3. Shqyrtimi i shkresës së Fakultetit të Edukimit për mos regjistrimin e studentëve në Fakultetin e Edukimit në Prizren dhe Gjilan.
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 24.06.2010.

Procesverbali i mbledhjes së datës 24.06.2010 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i shkresës së Fakultetit të Edukimit për mos regjistrimin e studentëve në Fakultetin e Edukimit në Prizren dhe Gjilan.

Kryesuesi, tha se sipas shkresës së Fakultetit të Edukimit dërguar Komisionit gjatë këtij viti akedamik nuk do të ketë regjistrim të studentëve në Fakultetin e Edukimit në Prizren dhe në Gjilan. Ai tha se lidhur me këtë shkresë në si Komisioni duhet të dalim me një rekomandim për këtë çështje dhe konsideron se ky qëndrim për mos regjistrim është i pa arsyeshëm dhe nuk i kontribuon çështjes në përgjithësi.

Heset Cakolli, tha se shkresa e drejtuar komisionit për mos regjistrim të studentëve në Fakultetin e Edukimit në Gjilan e Prizren bie në kundërshtim me marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe UP-së në njërin anë dhe në anën tjetër Kuvendin Komunal të Prizrenit, ai kërkoj që të sqarohen detajet dhe arsyet rreth këtij qëndrimi të marrë për mos regjistrim të studentëve në këtë vit akademik. Ai kërkon sqarim se lidhur me këtë çështje a është marrë vendim dhe kush e ka nxjerr atë.

Enis Kervan, tha se lidhur me këtë çështje nuk kemi informacione të sakta dhe nga takimet me delegacionet në Prizren nga senati i Universitetit të Prishtinës është marrë vendim që të vazhdohet regjistrimi i studentëve në Prizren. Ai mendon se çështje e regjistrimit të studentëve është me tepër politike dhe lidhur me këtë duhet pritur vendimin mbi procesin e Akreditimit i cili pritet që së shpejti të publikohet. Ai mendon se hapja e Universitetit të Prizrenit, Kosovën e ngrit në një nivel ndërkombëtar edhe nga fakti se Rektori që pritet të zgjidhet të jetë nga radhët e ndërkombëtarëve.

Adem Hajdaraj, tha se në fillimisht jemi informuar lidhur me një marrëveshje mirëkuptimi përmes se cilës Fakulteti i Edukimit duhet ti ofroj hapësirë pune Universitetit të Prizrenit dhe në ndërkohë kanë ardh informacionet që të mos pranojmë student të rinj në këtë vit akademi në Fakultetin e Edukimit në Gjilan e Prizren. Senati i UP-së ka marrë vendim që të vazhdohet me pranimin e studentëve të rinj ndërkohë që rektori është shprehur se kjo çështje ende nuk është përfunduar. Ai kërkon që komisioni të dal me një rekomandim që të përkrahët Fakultetin e Edukimit në mënyrë që të mos vjen deri të mbyllja e Fakultetit të Edukimit në Prizren e Gjilan.

Donika Kadaj – Bujupi, tha se komisioni duhet ti dijë arsyet lidhur me këtë çështje dhe për këtë kërkoj të sqarohen rrethanat e kësaj çështje.

Drita Kadriu, tha se lidhur me këtë çështje ndjehet e rezervuar nga se komisioni nuk posedon ndonjë dokument apo vendim i cili para shef mbylljen e këtyre institucioneve. Ajo tha se mund të zvogëlohet numri i studentëve por asesi të mbyllet një njësi akademike.

Ismail Kurteshi, lidhur me këtë çështje tha se në si komision duhet të bazohemi në informacione të sakta dhe me pas të marrim një rekomandim mbi bazën e këtyre informacioneve. Lidhur me këtë çështje komisioni duhet ti ftoj zyrtarët përgjegjës prej të cilëve do të marr informacione të sakta.

Komisioni vendosi qe për mbledhjen e ardhshme me dt.13.07.2010 të diskutohet kjo çështje dhe të ftohen përfaqësuesit e Kolegjiumit të drejtorive të arsimit.

4. Të ndryshme.

Donika Kadaj – Bujupi, kërkoj sqarim lidhur me atë se a i është dërguar Republikës Turke ndonjë shkresë sipas kërkesave të komisionit gjatë vizitës ditë me parë në Turqi. Kërkesa e komisionit ka qenë qe për studentët tanë të ndahen bursa për studime, Master e Doktoratur, gjë qe shteti turk ka shprehur gatishmëri për ndarjen e bursave të tilla dhe ne tani duhet te materializojmë këtë marrëveshje gojore pasi qe edhe koha është mjaft e shkurtër dhe viti akademik fillon shumë shpejt.

Arsim Rexhepi, kryetar, tha se ka përgatitur një letër falënderimi e cila është në fazën e përkthimit dhe se shpejti do ti dërgohet autoriteteve Turke.

Në këtë pikë u diskutua edhe lidhur me organizimin e konferencës ndërkombëtare e cila planifikohet të mbahet gjatë muajit tetor të këtij viti në Prishtinë.

Komisioni vendosi qe të drejtohet Kryesisë së Kuvendit me Kërkesë qe të mbulohet një pjesë e shpenzimeve për mbajtjen e konferencës Ndërkombëtare të arsimit.

Mbledhja e ardhshme mbahet me dt.13.07.2010 në ora 11:00, ku do të ftohen përfaqësuesit e Kolegjiumit të Drejtorive të Arsimit dhe do të debatohet lidhur me Shkresën e Dekanatit të Fakultetit të Edukimit.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 14: 30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Arsim Rexhepi